



Republika e Kosovës/
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
*Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javne Uprave - Ministry
of Public Administration*

Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

Disa Fakte mbi Mjedisin



ENTI I STATISTIKËS SË KOSOVËS
ZAVOD ZA STATISTIKU KOSOVA
STATISTICAL OFFICE OF KOSOVA



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo *Qeveria - Vlada*
- *Government*
Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javne Uprave - Ministry
of Public Administration

Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

Disa Fakte mbi Mjedisin



Enti i Statistikës së Kosovës
Zavod za Statistiku Kosova
Statistical Office of Kosovo

Botues: Enti i Statistikës së Kosovës (ESK)
Data e botimit: Shtator 2011
© : Enti i Statistikës së Kosovës
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.
E shtypur nga: K.G.T Prishtinë, Kosovë

Informata të shumta janë në dispozicion në internet, ku mund të qaseni
përmes ueb-faqes së ESK-së: www.ks-gov.net/esk

Hyrje

Ky është publikimi i tretë "Disa Fakte mbi Mjedisin", i cili ka për qëllim informimin statistikor të përdoruesve të ndryshëm mbi gjendjen e mjedisit në Kosovë. Gjithashtu publikimi synon të kontribuojë në krijimin e bazës së të dhënave dhe serisë kohore për indikatorët mjedisorë në Republikën e Kosovës.

Publikimi është realizuar nga Enti i Statistikës së Kosovës nëpërmjet përdorimit të të gjitha burimeve të disponueshme të të dhënave.

Ky publikim është rezultat i bashkëpunimit të ngushtë të Entit të Statistikës së Kosovës me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe AKMM (si ofrues i të dhënave).

Falënderime të veçanta i shkojnë Statistikave Suedeze për ofrimin e asistencës teknike, si edhe për Agjencinë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), gjithashtu dhe konsultantes afatgjatë të Statistikave Suedeze Zonjës Milva Ekonomi.

Ky publikim është përgatitur nga personeli i Departamentit të Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit në ESK :

Bajrush Qevani, Drejtor DSB&M

Mr.sc.Haki Kurti, Shef DSB&M

Arta Salihu, Zyrtare e lartë DSB&M

Tel: +381(0) 38235 111, ext. 133

Web-site: www.sok-kosovo.org

Interpretimet e shprehura në këtë publikim janë tërësisht të autorëve dhe nuk duhet t'i atribuohen, në ndonjë mënyrë, MAP, ESK, ose ndonjë institucioni tjetër.

Sugjerimet, propozimet dhe vërejtjet lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe na ndihmojnë ne që të jemi më efektiv ndaj përdoruesve .

Shtator, 2011

Kryeshefi Ekzekutiv,
Isa Krasniqi

Shkurtesat

ABESH	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Shtëpiake (ESK)
AESHB	Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore (ESK)
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore (ESK)
AMSJ	Anketa e Matjes së Standardit të Jetesës
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
ESK	Enti Statistikor i Kosovës
KEK	Korporata Elektroenergjetike e Kosovës
KFOR	Forcat e Kosovës
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MSH	Ministria e Shëndetësisë
NAG	Plehra minerale (Nitrati i amonit gëlqëror)
NPK	Plehra minerale (Azot, Fosfor, Kalium)
URE	Plehra minerale (Plehra minerale azotike)
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
IUCN	Organizata Botërore e Konzervimit të Natyrës
MI	Ministria e Infrastrukturës
TM1	Tre mujori i parë
GWh	Njësia matëse për energjinë elektrike (Giga wat orë energji)
MWh	Njësia matëse për energjinë elektrike (Mega wat orë energji) (1GWh=1000 MWh)
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik

Simbolet


-	Zero
:	Asnjë e dhënë
.	Jo e aplikueshme
0	E dhëna është më e vogël se gjysma e njësisë së përdorur
ha	Hektarë
kg	Kilogram
µg m ³	Mikrogram m ³
t	Ton
%	Për qindje
mg/ m ² .d	Lënda grimcore e depozituar

Përmbajtja

1. Informacion i përgjithshëm për Kosovën.....	8
2. Shfrytëzimi i tokës bujqësore.....	18
3. Biodiversiteti.....	29
3.1 Zonat e mbrojtura.....	29
3.2 Zonat e propozuara për mbrojtje.....	32
4. Mbeturinat.....	39
5. Uji.....	44
5.1 Burimet ujore.....	44
6. Energjia.....	47
7. Transporti.....	49
8. Ajri.....	53

Te dhënat e përgjithshme

The DPSIR model



Modeli DPSIR¹ është një shtrirje e modelit PRS (Presioni, Gjendja, Përgjigjia) e adoptuar nga grupi i Shteteve të Mjedisit (SoE) të OECD-së dhe Agjencia Europiane për Mjedisin (EEA), e përdorur gjithashtu edhe nga EUROSTAT për organizimin e statistikave të mjedisit. Ky kuadër analitik lejon organizimin e informacionit dhe integrimin e elementëve socio-ekonomik dhe ekologjikë, duke adresuar marrëdhëniet ndërmjet pesë kategorive të treguesve: Forcat drejtuese (p.sh., praktikat bujqësore, prodhimi industrial, teknologjia) dhe Presionet përcaktuese (p.sh., emisionet toksike, emisionet e CO₂), të cilat për pasojë po përkeqësojnë Gjendjen e mjedisit (p.sh., përqendrimin e merkurit në tokat pyjore, temperatura mesatare globale), të cilat ndikojnë (p.sh., acidifikimin e pyjeve, efektet përçarëse të endokrinës mbi gjitarët), duke imponuar përgjigjie të shoqërisë (p.sh., masa legjislative, taksa, programe kërkimi).

¹ Burimi: <http://www.esl.jrc.ec.europa.eu>, DPSIR model –Presioni –Gjendja -Përgjigjia

D Treguesit e **Forcave Drejtuese** nuk janë shumë përgjegjëse/reaguese (“*elastike*”): fenomeni i monitoruar, p.sh., trafiku rrugor, drejtohet nga forcat e fuqishme ekonomike, dhe rrjedhimisht vështirë se mund të pritët se këto tendenca do të ndryshojnë shumë në të ardhmen. Për shembull, politikanët nuk mund të sugjerojnë me seriozitet për shkatërrimin/heqjen e makinave private, nëse ata duan të qëndrojnë në zyrë. Megjithatë, treguesit e Forcave Drejtuese janë të dobishme në lidhje me:

- a) llogaritjen e një shumëllojshmërie treguesish të presionit, p.sh., duke shumëzuar kilometrazhin e makinave me koeficientet specifike si “mesatarja e CO₂ për makinë dhe km”;
- b) ndihmon vendimmarrësit për planifikimin e veprimeve (“përgjigjeve”) të nevojshme për shmangien e problemeve në të ardhmen (“presionet”), për shembull kapacitetin e rrugëve;
- c) shërbejnë si një bazë për skenarët e zhvillimit dhe planifikimin afatgjatë.

P Treguesit e **Presionit** tregojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë shkaqet e problemeve. Një tipar specifik i treguesve të presionit është se ato duhet të jenë *reaguese*, d.m.th, një vendimmarrës ka më të vërtetë një shans për të reduktuar treguesin (dhe kështu problemin), duke lançuar veprime të përshtatshme. Ato do të shërbejnë gjithashtu si një incentivë për zgjidhjet racionale, qëkur ato tregojnë *efektivitetin* e veprimit politik mjaftueshëm herët në kohë për të mbajtur përgjegjës ata të cilët kanë lançuar një veprim të tillë.

Gj Treguesit e **Gjendjes**, në të kundërt, shpesh janë shumë të ngadaltë. Për shembull, një tregues i gjendjes i cili tregon aciditetin e tokave pyjore tregon për emisionet e NO_x dhe SO₂ në dhjetë vitet e fundit; personat e përgjegjshëm politikisht mund të kenë dalë në pension gjatë kësaj kohe. Nga ana tjetër, treguesit e gjendjes mund të shërbejnë për të bërë një vlerësim të situatës (*cila është gjendja aktuale e tokave pyjore? Ku duhet të aplikohen masat korrektuese?*), dhe ato janë instrumente të përshtatshme për të planifikuar restaurimin e habitatit dhe aktiviteteve të ngjashme pastruese.

N Treguesit e **Ndikimit** reagojnë edhe më ngadalë sesa treguesit e gjendjes. Aty ku ndjehen ndikimet, shpesh është shumë vonë për veprim. Për më tepër, rrallë është e mundur për të vendosur lidhje të fortë statistikore ndërmjet presioneve, gjendjes dhe ndikimeve, për shkak të vonësive të mëdha dhe të influencës së variablave jomjedisore. Qëllimi kryesor i treguesve të ndikimit është tregimi i modeleve DPSIR, në veçanti: *zinxhirët shkak-efekt*, dhe për të lehtësuar diskutimet e


informuara rreth veprimeve për të shmangur ndikimet negative në të ardhmen. Në këtë kuptim, ato nuk janë “tregues” statistikor, por “modele shkencore diskutimi”.

1. Informacion i përgjithshëm mbi Kosovën

Kosova është një territor i cili gjindet në qendër të Gadishullit Ballkanik, pa dalje në det. Kosova kufizohet me Serbinë në Verilindje, Maqedoninë (FYROM), Shqipërinë në jugperëndim dhe Malin e Zi në Veriperëndim. Territori i Kosovës është 10908 km². Klima e Kosovës është kontinentale me verë të ngrohtë dhe me dimër të ftohtë. Kosova është e populluar me rreth 175 persona për km². Kryeqyteti i Kosovës është Prishtina.

Figura 1. 1: Harta e dendësisë së popullsisë në Kosovë

Dendësia e popullsisë sipas gridit për 1 km² në Kosovë në vitin 2009



Burimi: ESK, Hartografia

Tabela 1. 1: Koordinatat gjeografike

Kordinatat	Shkalla ⁰	Minutat'
Gjërësia veriore	43	16
Gjërësia jugore	41	53
Gjatësia lindore	21	47
Gjatësia Perëndimore	19	59

Burimi: ESK, Hartografia

Kosova shtrihet në pjesën jugore të kufirit gjeografik të gjysmë sferës veriore dhe ka kryesisht klimë kontinentale me disa influenca mesdhetare dhe alpine. Faktorët lokalë kryesorë të cilët influencojnë klimën e Kosovës janë: relievi i saj, ujërat, toka dhe bimët.

Në Kosovë janë të pranishme të gjitha format e reshjeve atmosferike. Reshjet më të rëndësishme janë në formën e shiut në lugina dhe reshjet në formën e borës në male. Në Kosovë ka mesatarisht 160 ditë me shi në vit. Komuna e Prishtinës është 572 km² dhe shtrihet në veriperëndim të Kosovës.

Tabela 1.2 tregon se në vitin 2006 temperatura maksimale në Korrik ka qenë 27.5° C, në Korrik 2007 ka qenë 31.9 ° C, në Gusht 2008 ishte 30.1 ° C, përderisa temperatura minimale ka qenë në Janar 2006, - 7.5 ° C, 2007, - 3.6 ° C, dhe 2008, - 3.9 ° C.

Tabela 1. 2: Temperaturat e ajrit në Prishtinë, 2006 – 2008. °C

Muaji	2006		2007		2008	
	Max	Min	Max	Min	Max	Min
Janar	0,6	-7,5	9,6	1,2	4,7	-3,9
Shkurt	4,1	-5	9,7	0,8	10,1	-2,7
Mars	9,8	0,3	13,6	2,3	13,2	1,7
Prill	17,2	6,9	19,2	3,9	17,2	5,6
Maj	21,3	9,1	22,8	10,5	28,8	8,7
Qershor	24,9	12	28,2	14,2	26,3	13,1
Korrik	27,5	13,7	31,9	14,5	27,8	14,2
Gusht	27,2	13,5	30,4	15,3	30,1	14,6
Shtator	23,4	10,3	22	8,7	21,6	9,7
Tetor	19,5	6,1	15,5	6	19,6	6,0
Nëntor	10,5	1,4	6,4	-0,8	13,3	3,0
Dhjetor	4,7	2,3	2,7	-3,6	7,1	0,7

Burimi: KFOR HQ Meteorologjik

Tabela 1.3: Tregon gjithsej numrin e ditëve me të reshura në vitin 2009 në Prishtinë, muaji me numrin më të madh të ditëve me të reshura ka qenë Dhjetori me 18 ditë, ndërsa në vitin 2010 ishte muaji Dhjetor me 20 ditë. Temperatura më e ulët në vitin 2009 ka qenë – 3.8 °C në muajin janar, ndërsa temperatura më e lartë ka qenë 28.6 °C në muajin gusht. Në vitin 2010 temperatura më e lartë ka qenë 30.4 °C në muajin gusht.

Tabela 1. 3: Temperatura e ajrit në Prishtinë, 2009-2010 dhe TM1 2011, numri i ditëve me të reshura

Viti - Muaji	Temperatura (°C)		Ditët me shi/borë
	Max	Min	
2009-01	3.3	-3.8	16
2009-02	5.5	-2.3	14
2009-03	10.1	0.6	17
2009-04	18.8	6.4	11
2009-05	23.5	9.7	10
2009-06	24.3	12.7	13
2009-07	28.2	14.3	7
2009-08	28.6	12.8	7
2009-09	24.1	11.2	11
2009-10	16.5	6.1	14
2009-11	13.6	2.4	11
2009-12	7.8	0.7	18
2010-01	4.4	2.5	17
2010-02	7.2	1.1	19
2010-03	11.8	1.3	17
2010-04	16.7	4.1	17
2010-05	21.4	9.8	15
2010-06	25.3	12.9	7
2010-07	28.0	15.0	7
2010-08	30.4	15.0	5
2010-09	23.4	10.0	9
2010-10	14.7	5.5	17
2010-11	15.8	5.1	15
2010-12	6.7	-1.5	20
2011-01	4.3	-4.1	8
2011-02	4.0	-4.1	10
2011-03	11.1	1.0	8

Burimi: KFOR HQ Meteorologjik


Tabela 1.4: Popullsia sipas grupmoshës dhe gjinisë, 2009 në për qindje

Sipas moshës	Meshkuj	Femra
<15	29,2	27,2
15-24	18,8	16,6
25-54	37,3	40,6
55-64	7,2	7,6
65+	7,5	8
15-64	63,3	64,8

Burimi: ESK, Anketa e Fuqisë Punëtore, 2009

Kosova ka një popullsi relativisht të “re”, me pothuajse një të tretën e popullsisë nën 15 vjeç dhe 7.8 % e popullsisë mbi moshën 65 vjeç. Struktura e këtillë është tipike për piramidën klasike të popullsisë. Kjo gjithashtu bëhet e dukshme nëse njehsohet madhësia mesatare e grupmohave që përdoret në analizën e tregut të punës për vite të vetme (shiko grafikun 1.2).

Grafiku 1.2: Popullsia sipas grupmoshës dhe gjinisë, 2009 në për qindje



Burimi: ESK, Anketa e Fuqisë Punëtore, 2009

Të punësuarit në bujqësi në vitin 2002 kanë arritur ngritje në 10.3 %, ndërsa në vitin 2004 ishte 24.7 %, por në vitin 2009 kemi një rënie në 6.2 %.

Në Sektorin e Administratës Publike janë punësuar më shumë persona në vitin 2009 krahasuar me vitin 2002.

Gjithashtu në sektorin e shëndetësisë ka pasur një rritje të punësimit nga 6.5 për qind në vitin 2009, në 7.0 për qind në 2009.

Tabela 1. 5: Të punësuarit sipas aktiviteteve ekonomike, 2002–2009 në për qindje

Aktivitetet ekonomike	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Bujqësi	10,3	17,3	24,7	18,8	21,4	14,6	8,0	6,2
Miniera	1,6	1,4	1,1	1,6	1,5	1	1,5	1,1
Industri	10,7	10,5	8,6	9,6	7,3	10,4	8,7	9,9
Energjetike	4,9	3,5	4,3	3,2	3,6	2,7	5,2	4,5
Ndërtimtaria	11,2	11,3	8,0	7,9	8,1	6,6	8,6	7,9
Tregtia	17,0	13,9	13,9	13,8	16,4	16,9	17,1	17,4
Hoteleria	3,9	3,0	3,3	3,5	2,8	3,9	4,5	4,6
Transporti	4,1	4,4	4,7	4,2	3,7	4,5	5,6	5,8
Financa	0,8	0,9	1,1	1,1	1,4	1,1	1,8	2,2
Biznes	0,7	0,8	2,2	2,4	2,1	1,4	2,6	2,9
Administratë publike	8,7	9,4	6,7	8,2	7,8	9,6	9,7	9,8
Arsim	11,2	12,0	10,6	10,8	11,7	12,1	13,6	13,4
Shëndetësi	5,7	5,1	4,6	5,2	5,4	7,0	6,5	7,0
Të tjera	9,2	6,5	6,4	9,7	7,0	8,3	6,7	7,5

Burimi: ESK, Anketa e Fuqisë Punëtore, 2009

Numri më i madh i njerëzve të punësuar në Administratën Publike, punojnë në Sektorin e Arsimit, i ndjekur nga Shëndetësia, Rendi dhe Siguria Publike.


Ndërsa në sektorin e mjedisit është shkalla më e ulët e punësimit për vitet 2006-2009, janë vetëm 0.3 % e numrit gjithsej të të punësuarve të cilët punojnë në këtë sektor (shiko tabelen 1.6), ndërsa në vitin 2010 vërehet një rritje e lehtë 0.4 për qind.

Tabela 1. 6: Gjithsej të punësuarit në Administratën Publike

Sektori	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
	%	%	%	%	%	%	%	%
Shërbime të përgjithshme	12,0	12,6	12,3	11,8	10,9	10,7	11,4	13,8
Rendi publik	18,9	20,8	21,7	23,4	23,5	23,4	22,3	21,8
Arsimi	45,2	43,4	42,7	42,7	43,4	43,8	44,2	43,2
Shëndetësia	19,5	18,4	17,9	17,6	17,8	17,6	18,2	17,5
Ekonomia	1,9	2,1	2	1,4	1,7	1,8	1,8	1,7
Kultura dhe rekreacioni	0,6	0,7	0,7	0,6	0,4	0,4	0,4	0,3
Strehimi	1,6	1,7	2,3	2,1	2,0	2,0	1,5	1,4
Ambienti	0,3	0,4	0,4	0,3	0,3	0,3	0,3	0,4
Gjithsej	100	100	100	100	100	100	100	100

Burimi: MSHP, Drejtoria e administrimit të listëpagesave dhe pagave

Grafiku 1. 3: Gjithsej të punësuarit në administratën publike në për qindje



Burimi: ESK, Anketa e Fuqisë Punëtore, 2009

Tabela 1.7: Tregon se BPV në Kosovë për vitet 2004-2009 është rritur në shifrat prej 2 912. 5 milion euro në 3 912 4 milion euro.

BPV për banorë është rritur prej 1 427 euro në 2004, në 1 795 në vitin 2009. BPV si konsum final i ekonomive shtëpiake është rritur nga 2 487 6 milion nga viti 2004 në 3 584 3 milion euro në vitin 2009.

Tabela 1.7: BPV sipas shpenzimeve të arritura për vitet 2004-2009, sipas çmimeve aktuale (në milion euro).

BPV me çmime aktuale	2004	2005	2006	2007	2008	2009
	2.912,5	3.002,9	3.120,4	3.393,7	3.851,4	3.912,4
Shpenzimet e konsumit final	3.212,7	3.367,6	3.466,2	3.810,6	4.344,6	4.279,9
Shpenzimet e konsumit final te ekonomive shtëpiake	2.487,6	2.638,4	2.770,8	3.145,9	3.646,7	3.584,3
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	701,5	705,5	670,6	641,6	674,4	670,5
Qeveria e Kosovës	355,5	329,2	340,8	327,3	372,6	409,7
Donatorët (pagat)*	346,0	376,3	329,8	314,3	301,8	260,8
Të punësuarit të huaj	247,8	258,4	213,2	196,9	196,9	178,7
Të punësuar vendor	98,2	117,9	116,6	117,4	104,9	82,1
Shpenzimet e konsumit final të IJPSHESH	23,5	23,7	24,8	23,1	23,6	25,0
Formimi i bruto kapitalit	701,2	722,2	798,3	892,5	1.093,9	1.166,5
Formimi i bruto kapitalit fiks	583,6	592,8	657,1	744,3	937,9	1.026,5
Ndryshimet në inventar	117,7	129,4	141,2	148,3	156,0	140,0
Eksporti neto	-1.001,4	-1.086,9	-1.144,1	-1.309,4	-1.587,1	-1.534,0
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	310,6	332,8	441,4	512,2	569,0	611,8
Eksporti i mallrave	63,8	67,8	122,5	177,2	217,5	177,2
Eksporti i shërbimeve	246,8	265,0	319,0	335,0	351,6	434,6
Importi i mallrave dhe shërbimeve	1.312,0	1.419,7	1.585,5	1.821,7	2.156,1	2.145,8
Importi i mallrave	1.046,9	1.146,3	1.295,6	1.545,2	1.885,7	1.850,6
Importi i shërbimeve	265,1	273,3	289,9	276,5	270,5	295,1
Popullsia (000)	2.041	2.070	2.100	2.130	2.153	2.180
BVP për kokë banori (Euro)	1.427	1.451	1.486	1.593	1.789	1.795

Burimi: ESK, Statistikat Ekonomike, BPV 2004-2009

Tabela 1.8: Tregon se, formimi i bruto kapitalit ka kontribuar me 28.9 për qind në BPV në vitin 2009. Shpenzimet e konsumit final të qeverisë në periudhën 2004-2009 kanë përfaqësuar 24.7-17.1 për qind të BPV-së 2009

*Përfshinë pagat e të punësuarve rezident të UNMIK-ut, Eulex-it (personeli lokale dhe të huaj të cilët qëndrojnë më gjatë se një vit në Kosovë)

Tabela 1.8: Struktura e BPV sipas shpenzimeve, 2004- 2009

BPV me çmime aktuale	2004	2005	2006	2007	2008	2009
	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0
Shpenzimet e konsumit final	110,3	112,1	111,1	112,3	112,8	109,4
Shpenzimet e konsumit final te ekonomive shtëpiake	85,4	87,9	88,8	92,7	94,7	91,6
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	24,1	23,5	21,5	18,9	17,5	17,1
Qeveria e Kosovës	12,2	11,0	10,9	9,6	9,7	10,5
Donatorët (pagat)	11,9	12,5	10,6	9,3	7,8	6,7
Të punësuar te huaj	8,5	8,6	6,8	5,8	5,1	4,6
Të punësuar vendor	3,4	3,9	3,7	3,5	2,7	2,1
Shpenzimet e konsumit final të LPSHESH	0,8	0,8	0,8	0,7	0,6	0,6
Formimi i bruto kapitalit	24,1	24,1	25,6	26,3	28,4	29,8
Formimi i bruto kapitalit fiks	20,0	19,7	21,1	21,9	24,4	26,2
Ndryshimet në inventar	4,0	4,3	4,5	4,4	4,1	3,6
Eksporti neto	-34,4	-36,2	-36,7	-38,6	-41,2	-39,2
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	10,7	11,1	14,1	15,1	14,8	15,6
Eksporti i mallrave	2,2	2,3	3,9	5,2	5,6	4,5
Eksporti i shërbimeve	8,5	8,8	10,2	9,9	9,1	11,1
Importi i mallrave dhe shërbimeve	45,0	47,3	50,8	53,7	56,0	54,8
Importi i mallrave	35,9	38,2	41,5	45,5	49,0	47,3
Importi i shërbimeve	9,1	9,1	9,3	8,1	7,0	7,5


Burimi: ESK, Statistikat Ekonomike, BPV 2004-2009

2. Shfrytëzimi i tokës bujqësore

Sipërfaqja totale e tokës në Kosovë prej afërsisht 1,1 milion hektarë konsiston në 570 000 hektarë tokë bujqësore, nga të cilat afërsisht 300 000 hektarë janë tokë të lërueshme. Tokat e tjera bujqësore janë kryesisht kullota (165 000 hektarë) dhe livadhe (90 000 hektarë). Sipërfaqja pyjore përbën rreth 450 000 hektarë.

Regjistrimi më i detajuar i përdorimit të tokës mund të gjendet në regjistrin e Kadastrës.

Grafiku 2.1: Shfrytëzimi i tokës bujqësore në Kosovë sipas Regjistrit të Kadastrës, 2002, hektarë



Burimi: Agjencioni Kadastral i Kosovës

Sipas AESHB 2008, pjesa më e madhe e tokës bujqësore, 39.9 për qind, është ara dhe kopshte; kategoria e dytë më e madhe përbëhet nga livadhet dhe kullosat 29.3 për qind. Në bazë të anketës, 5 për qind e tokës bujqësore është lënë djerrinë.

Toka bujqësore në pronësi ose që shfrytëzohet nga ekonomitë shtëpiake, zë rreth 75.7 % të sipërfaqes totale të ekonomive shtëpiake bujqësore. Pjesa e mbetur është me pyje dhe oborre shtëpish dhe tjera. (shiko tabelën 2.1).


Toka bujqësore përfshinë: arat, kopshtet, pemishtet, vreshtat, livadhet, kullosat dhe djerrinat (kopshtet janë mbledhur në kategorinë e tokës ara dhe kopshte për thjeshtëzim të grumbullimit të të dhënave).

Tabela 2. 1: Shfrytëzimi total i tokës brenda sektorit të ekonomive shtëpiake bujqësore 2008, ha në përqindje

Shfrytëzimi total i tokës	Sip. (ha)	%
Ara dhe kopshte	138813	39,9
Pemishte	4207	1,2
Vreshta	1173	0,3
Serra	255	0,1
Livadhe	98369	28,2
Gjithsej tokë e kultivuar	242817	
Kullosa	3894	1,1
Djerrina	17454	5,0
Gjithsej tokë bujqësore	21348	
Male	70922	20,3
Oborre shtëpish	12423	3,6
Të tjera**	1479	4,0
Gjithsej	348989	100,0

Burimi: ESK, Anketa Shtëpiake e Ekonomive Bujqësore, 2008

Grafiku 2. 2: Shfrytëzimi i tokës bujqësore, 2008



Burimi: ESK, Anketa Shtëpiake e Ekonomive Bujqësore, 2008

Tabela 2.2 tregon të dhënat e shfrytëzimit të tokës bujqësore sipas komunave në Kosovë. Prizreni ka pronësi më të madhe të tokës me 63 569 ha. Sipërfaqe afërsisht të njëjtë ka edhe Podujeva me 63 333 ha, Peja ka 60 363 ha, Prishtina dhe Gjakova kanë sipërfaqe afërsisht të njëjtë, 57 264 ha me 58 830.

**Të tjera, shfrytëzimi i tokës për qëllime infrastrukturore

Tabela 2.2: Përdorimi i tokës në Kosovë sipas Regjistrit të Kadastrës, (ha) sipas komunave

Komuna	Tokë bujqësore	Tokë pyjore	Sipërfaqe ujore	Sipërfaqet tjera	Sipërfaqja gjithsej
Deçan	15 860	19 028	341	1 991	37 220
Gjakovë	23 296	26 753	896	7 885	58 830
Gllgovc	15 512	10 474	142	1 469	27 597
Gjilan	24 843	24 237	491	1 988	51 559
Dragash	34 430	6 434	201	1 578	42 643
Istog	23 233	20 692	324	1 191	45 440
Kaçanik	10 497	17 293	315	1 351	29 456
Klinë	17 767	11 566	377	1 231	30 941
Fushë Kosovë	7 128	1 382	100	929	9 539
Kamenicë	29 006	20 395	1 030	1 894	52 325
Mitrovicë	16 894	14 354	461	1 950	33 659
Leposaviq	23 273	27 512	521	2 664	53 970
Lipjan	24 686	12 962	326	2 198	40 172
Novobërdë	4 998	2 781	47	308	8 134
Obiliq	8 575	1 153	132	634	10 494
Rahovec	18 344	7 610	492	1 195	27 641
Pejë	31 274	25 715	841	2 533	60 363
Podujevë	34 193	25 968	617	2 555	63 333
Prishtinë	25 259	28 359	378	3 268	57 264
Prizren	34 574	24 800	784	3 411	63 569
Skenderaj	20 553	15 224	247	1 465	37 489
Shtime	6 449	6 377	106	525	13 457
Shtërpcë	13 651	10 332	201	608	24 792
Suharekë	19 373	15 070	444	1 255	36 142
Ferizaj	19 769	12 824	176	1 743	34 512
Viti	17 854	9 937	310	1 271	29 372
Vushtrri	21 756	10 431	718	1 618	34 523
Zubin Potok	10 133	20 773	1 037	1 434	33 377
Zveçan	5 379	5 970	129	837	12 315
Malishevë	15 672	13 842	159	1 004	30 677
Gjithsej	574 231	450 249	12 344	53 979	1 090 803

Burimi: Agjencioni Kadastral i Kosovës, 2002

Tabela 2.3 tregon shpërndarjen e fermave për nga madhësia. Fermat klasifikohen në 11 grupe në bazë të sipërfaqes së tokës së tyre bujqësore.

Struktura shumë e fragmentuar e fermës pengon zhvillimin e bujqësisë komerciale dhe çon kah prodhimi jo-komercial.

Tabela 2. 3: Toka bujqësore sipas madhësisë dhe strukturës së fermës, 2008

Madhësia e fermës	Fermat e vogla			Fermat e mëdha dhe të specializuara			Gjithsej		
	Nr. i fermave	Sip.(ha)	% e fermave	Nr. i fermave	Sip.(ha)	% e fermave	Nr. i fermave	Sip.(ha)	% e fermave
0.01-0.5ha	38 635	11 064	21,9	11	3	4,5	38 646	11 067	21,9
0.51-1ha	45 084	33 812	25,5	19	15	7,7	45 103	33 827	25,6
1.01-1.5ha	43 531	52 749	24,7	13	16	5,3	43 544	52 765	24,6
1.51-2ha	14 836	25 684	8,4	15	28	6,1	14 851	25 712	8,4
2.01-3ha	18 702	45 626	10,6	27	67	10,9	18 729	45 693	10,6
3.01-4ha	6 353	21 674	3,6	15	52	6,1	6 368	21 726	3,6
4.01-5ha	3 401	15 062	1,9	16	72	6,5	3 417	15 134	1,9
5.01-6ha	1 710	9 243	1,0	10	54	4,0	1 720	9 297	1,0
6.01-8ha	1 926	13 145	1,1	18	127	7,3	1 944	13 272	1,1
8.01-10ha	903	8 000	0,5	22	195	8,9	925	8 195	0,5
Mbi 10 ha	1 374	24 140	0,8	81	3 337	32,7	1 455	27 477	0,8
Gjithsej	176 455	260199	100,0	247	3966	100,0	176702	264165	100,0

Burimi: ESK, Anketa Shtëpiake e Ekonomive Bujqësore, 2008

¹ **Përkufizime (fermat e vogla)**


Përkufizimi i një ekonomie shtëpiake është një bashkësi e personave që jetojnë së bashku, grumbullojnë dhe shpenzojnë të ardhurat e tyre të përbashkëta.

Përkufizimi i një ekonomie shtëpiake bujqësore është ekonomi e cila zotëron dhe kultivon më shumë sesa 0.10 hektarë tokë të lërueshme të përdorshme, ose më pak sesa 0.10 hektarë toke të lërueshme të përdorshme, por që ka të paktën:

- 1 lopë dhe një viç, ose 1 lopë dhe 1 mëshjtjerrë,
- 1 lopë dhe 2 frymë dele ose dhi të rritura,
- 5 dele ose dhi të rritura,
- 4 dele të rritura dhe derra së bashku,
- 3 derra të rritur,
- 50 shpezë të rritura,
- 20 koshere bletësh, ose
- mbi 20 m² hurdhë për peshq.

Duke marrë në konsideratë të gjitha fermat së bashku, Grafiku 2.3 tregon se 47.5 për qind e tokës bujqësore, është nën fermat në mes 0.01 - 1 ha. Struktura shumë e fragmentuar e fermës pengon zhvillimin e bujqësisë komerciale dhe çon kah prodhimi jo-komercial.

Grafiku 2. 3: Shpërndarja e tokës bujqësore në grupe të ndryshme të madhësisë se fermave



Burimi: ESK, Anketat Shtëpiake e Ekonomive Bujqësore, 2008

Numri i kafshëve shtëpiake të paraqitura në tabelën 2.4 janë nga nëntori i vitit 2008.

Gjedhët janë kafshët shtëpiake më të rëndësishme, prej të cilave 56 për qind janë lopë qumështore.

Ekonomitë shtëpiake kanë një numër të vogël të buallicave, rreth 412, të cilat janë përfshirë në numrin e përgjithshëm të gjedhëve.

Numri mesatar i lopëve qumështore për ekonomi shtëpiake bujqësore është 1.07.

Tabela 2. 4: Numri i kafshëve shtëpiake Nëntor 2008

Lloji i kafshëve	Numri i kafshëve gjithsej
Gjedhe	341608
Viqa më të ri se 6 muaj	75476
Mëzet dhe meshqerra 6 muaj deri 1 vjeq	50206
Mëzet dhe meshqerra 1 deri 2 vjeq	17720
Dema dhe meshqerra me teper se 2 vjeq	5199
Lope qumeshtore	191529
Qe	1066
Buallica	412
Derra	26770
Gica deri ne 6 muaj	17874
Dosa per mbaresim	7312
Harqa për riprodhim	1584
Dele dhe Dhi	180128
Qengja	27552
Dele për mbaresim	124129
Desh per riprodhim	9672
Dhi	8918
Dhi qumështore	9857
Kuaj dhe gomare	5301
Kuaj	4973
Gomare	328
Shpez	2213406
Pula	2046925
Shpez të tjera	166481
Blete (Koshere)	43297

Burimi: ESK, Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore 2008

Tabela 2.5. paraqet përdorimin e llojeve të ndryshme të plehrave minerale dhe tabela 2.12 paraqet përdorimin e plehut organik. Plehurat minerale përdoren nga shumica e fermerëve. NPK, shpesh i shfrytëzuar për plehërim themelor gjatë mbjelljes, është më i shfrytëzuar prej të gjitha plehrave joorganike. Shumica e pjesës tjetër janë NAG dhe URE, të cilat kryesisht përdoren për riplehërim pas mbirjes së bimës.

Sasia mesatare e plehut mineral të përdorur është 346 kg/ha. Ndërsa sasia mesatare plehut organik të përdorur është 2845 kg /ha.

Tabela 2. 5: Përdorimi i plehrave minerale në kulturat bujqësore, 2008

Grupi i kulturave	Plehu mineral									
	Sipërfaqja ha	NPK	NPK	NAG	NAG	URE	URE	Te tjere	Të tjere	Gjithsej(NPK ,NAGURE të tjere)
		kg	kg/ha	kg	kg/ha	kg	kg/ha	kg	kg/ha	kg/ha
Drithera	98 543	27883029	283	12803314	130	12319135	125	329763	3	541
Perime	11 613	4180194	360	2480189	214	991366	85	96437	8	667
Peme	5096	1274441	250	268272	53	188080	37	35903	7	347
Bime foragjere	104763	6354116	61	2842600	27	3934648	38	130552	1	127
Të tjera	319	50038	157	28440	89	4420	14	1572	5	165
Gjithsej	220334	39741818	180	18422815	84	17437649	79	594227	3	346

Burimi: ESK, Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore, 2008

Tabela 2. 6: Përdorimi i plehut organik sipas grupit të kulturës bujqësore, 2008

Grupi i kulturave	Plehu organik		
	Sipërfaqja (ha)	ton	kg/ha
Drithëra	98543	284281	2885
Perime	11613	98686	8498
Pemë	5096	21367	4193
Bimë foragjere	104763	221203	2111
Të tjera	319	1346	4219
Gjithsej	220334	626883	2845

Burimi: ESK, Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore, 2008

Tabela 2.7. Tregon sipërfaqen gjithsej të tokës së ujitur të paraqitur në hektar sipas rajoneve dhe tabela 2.9 paraqet indikatorët e njëjtë sipas komunave.

Ujitja, siç është raportuar nga fermerët, shfrytëzohet në rreth 42226 ha. Për nga rajoni, pjesa më e madhe e tokës së ujitur është në Pejë dhe Gjakovë.

Sipas komunave, pjesa më e madhe e sipërfaqes së ujitur është në Pejë, Deçan, Rahovec, Gjakovë dhe Istog.

Tabela 2. 7: Ujitja e tokës së kultivuar sipas rajoneve, 2008

Rajonet	Sipërfaqja e ujitur (ha)	Sipërfaqja e pa ujitur (ha)	Gjithsej sipërfaqja (ha)
Kosova	42226	195575	237801
Prishtina	3741	51624	55365
Mitrovica	2861	37047	39908
Peja	13915	17848	31763
Gjakova	13311	17313	30624
Prizreni	3784	22190	25974
Ferizaj	2833	18680	21513
Gjilani	1781	30873	32654

Burimi: ESK, Anketa Shtëpiake e Ekonomive Bujqësore 2008.

Tabela 2.8. Tregon ujitjen e tokës së kultivuar sipas komunave. Siç është raportuar nga fermerët ujitja (AESHB 2007), shfrytëzohet në rreth 39 369 ha. Për nga rajoni, pjesa më e madhe e tokës së ujitur është në Pejë dhe Gjakovë.

Sipas komunave, pjesa më e madhe e sipërfaqes së ujitur është në Pejë, Deçan, Rahovec, Gjakovë dhe Istog.

Ujitja është një investim bujqësor me kosto të lartë dhe disa fermerë nuk kanë kushte për ta bërë atë. Gjatë vitit shumë fermerë janë të detyruar të presin që të reshurat atmosferike t'i zgjidhin problemet e tyre.

Tabela 2. 8 : Ujitja e tokës së kultivuar sipas komunave, 2008

Rajonet	Sipërfaqja e ujitur (ha)	Sipërfaqja e pa ujitur (ha)	Gjithësej
			Sipërfaqja (ha)
Kosova	42226	195575	237801
Deqani	5144	4423	9567
Gjakova	3626	7333	10959
Glllogoci	108	4202	4310
Gjilani	285	8953	9238
Dragashi	496	4174	4670
Istogu	3831	6849	10680
Kaqaniku	293	3019	3312
Klina	2418	5623	8041
F.Kosova	202	5817	6019
Kamenica	509	8779	9288
Mitrovica	790	4661	5451
Leposaviqi	33	369	402
Lipjani	1170	16570	17740
Novoberda	36	1574	1610
Obiliqi	416	3211	3627
Rahoveci	4541	5556	10097
Peja	7666	5376	13042
Podujeva	1163	11743	12906
Prishtina	647	8508	9155
Prizreni	1739	5722	7461
Skenderaj	497	20433	20930
Shtimja	576	3847	4423
Shtërpca	1274	471	1745
Suhareka	1167	5592	6759
Ferizaji	688	11343	12031
Vitja	987	13141	14128
Vushtrria	1210	9880	11090
Z.Potoki	202	1261	1463
Zveqani	129	444	573
Malisheva	383	6701	7084

Burimi: ESK, Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore, 2008

3. BIODIVERSITETI

3.1 Zonat e mbrojtura

Kosova është e njohur për biodiversitetin e saj të pasur. Pozicioni dhe faktorët gjeografik, pedologjik, hidrografik, peisazhet dhe klima janë disa nga faktorët të cilët i kanë dhënë Kosovës një diversitet biologjik, peisazhe, shumëllojshmëri floristike, bimësi dhe faunë.

Në territorin e Kosovës vlerat e mbrojtura natyrale përbëjnë një sipërfaqe prej 46 437 ha, (4,25 përqind të territorit të Kosovës). Deri më tani janë marrë në mbrojtje 75 zona të natyrës dhe janë propozuar 195 të tjera. Në zonat e mbrojtura përfshihen: 1 Park Kombëtar (Malet e Sharrit), 11 Rezervate të Natyrës (Bifurgacioni i lumit Nerodime, Rezervati i Arnenit, Maja e Ropsit, Rusenica etj), 59 Monumente të Natyrës (Burimi i Drintit të Bardhë, Shpella e Gadimes, Gryka e Rugovës, Ura e Shenjtë, Trungjet e Vjetra, etj), dy Parqe Regjionale të Natyrës (Gërmia dhe Mirusha), dhe dy parqe pyjore – Pishat e Deçanit dhe Ravane.

Tabela 3. 1: Zonat e mbrojtura të natyrës sipas kategorive në Kosovë

Emërtimi	Nr. i zonave	Sipërfaqja /ha
Rezervate të Natyrës	11	847
Bimore	7	
Shtazore	2	
Speciale	2	
Park Kombëtar	1	39
Monument Natyre	59	4 874
Spelologjike	4	
Hidrologjike	10	
Gjeomorfologjike	5	
Botanike	36	
Memoriale	3	
Muzeu i Kristaleve në Strantërg	1	
Park Regjional	2	1 681
Park Pylli	2	35
Gjithsej	75	46 437

Burimi: AKMM

Tabela 3. 2: Rezervatet e natyrës sipas komunave, sipërfaqes dhe vitit të themelimit

Emri	Komuna	Sipërfaqja në hektarë	Viti i themelimit
Maja e Ropsit	Pejë	20	1955
Gubavci	Prizren	38	1959
Popovo prase	Prizren	30	1960
Gazimestan	Prishtinë	12	1953
Kozhnjeri	Deçan	15	1955
Oshljaku	Prizren	20	1960
Malet e Prelepit	Deçan	1	1963
Rusenica	Suharekë	300	1955
Bifurkacioni i lumit Nerodime	Ferizaj	13	1979
Golem bor	Prizren	35	1960
Kamilja	Leposaviq		1988


Burimi: MMPH, IMN

Tabela 3. 3: Zonat e mbrojtura në Kosovë dhe klasifikimi i tyre sipas IUCN

Llojet e zonave	Rangu IUCN	Nr. i zonave	Sipërfaqja (ha)	%
Zonat natyrore	I	11	698	2
Parku nacional	II	1	39 000	85
Monumentet natyrore	III	35	4 867	11
Sipërfaqet e mbrojtura	IV	2	1 681	3
Gjithsej		49	46 246	100.00

Burimi: MMPH, IMN (2005)

Harta e zonave të mbrojtura në territorin e Kosovës



Burimi: MESP, INP and GIS

Tabela 3.5: Zonat e propozuara për mbrojtje 2002-2007

Emërtimi i zonës	Komuna
Gurbadh - Trungu i Qarrit	Malishevë
Burim - Trungu Frashrit	Malishevë
Turjak - Trungu i Qarrit 2	Malishevë
Panorc - Shpella e Flladit	Malishevë
Drenovc - Trungjet në Varrezat e fshatit	Malishevë
Drenovc - Shpella e Bozhurit	Malishevë
Budavec - Mali i Vakafit	Malishevë
Vermicë - Lagj.e Limanajev	Malishevë
Balincë - Mali i Vakafit	Malishevë
Marali - Guri i Maralis	Malishevë
Marali - Trungi i Qarrit	Malishevë
Pagarush - Trungi i Qarrit	Malishevë
Gurisht - Burimi i Ujitë	Malishevë
Pidiq - Burimi Termomineral	Gjilan
Nasalë - Burim Mineral	Gjilan
Gumnishtë - Burim Mineral	Gjilan
Llashticë - Trungu i Qarrit	Gjilan
Lipovicë - Dy Trungje të Dardhesë	Gjilan
Buricë - Dy Trungje të Bungut	Gjilan
Uglarë - Burim i Ujit Termal	Gjilan
Lovcë - Trungu i Bungut	Gjilan
Lugina e lumit Llapushnik	Gjilan
Kmetovc - Burimi Termomineral	Gjilan
Brisallc - Shpellë	Gjilan
Perplenic - Liqeni i Perplnicës	Gjilan
Parku Regjional " Pashtriku "	Gjakovë
Park Pyjor " Maja e Gllavës "	Gjakovë
Kompleksi i Pishinës së Zezë në Shkukëz	Gjakovë
Herreq - Lisi i Qarrit	Gjakovë
Stubullë - Trungu i Blirit	Gjakovë
Berijah - Trungjet e Blirit	Gjakovë
Dobrosh - Lisi i Bungut	Gjakovë
Rracaj - Trungu i Blirit	Gjakovë
Vogovë - Lisi i Qarrit	Gjakovë
Mulliq - Burimi i Ujitë	Gjakovë
Burimi i lumit Dëshica " Gurra e Demjanit "	Gjakovë
Kusar - Burimi i Ujit	Gjakovë
Potok - Burimi i Ujit	Gjakovë
Shpella e Qiriut	Gjakovë
Shpella e Kusarit	Gjakovë
Përberja e Bashkësis së Brukës	Gjakovë
Lokaliteti i Byjgerit dhe i Dioskoresë	Gjakovë
Lokaliteti i lule Bozhures në Pashtrik	Gjakovë
Trungu i Tisit	Gjakovë
Bashkësia Boshtrës dhe Gështenjës	Gjakovë
Shqiponjë - Zabeli i Gojanit	Gjakovë

Tabela 3.5: (vazhdim) Zonat e propozuara për mbrojtje 2002-2007

Greçinë - Trungu i Qarrit	Gjakovë
Molliq - Trungjet e Dushkut	Gjakovë
Madanaj - Trungu i Qarrit	Gjakovë
Bec - Trungu i Bungut	Gjakovë
Zhabel - Trungjet e Dushkut	Gjakovë
Gergoc - Trungjet e Dushkut	Gjakovë
Potok (2) - Burimi i Ujit 2	Gjakovë
Ujmirë - Trungu i Bungut	Klinë
Deiq - Trungu i Bungut	Klinë
Negllavk - Trungu i Qarrit	Klinë
Gllarevë - Trungu i Bungut	Klinë
Dresnik - Banja e Dresnikut	Klinë
Sibovcë - Trungjet e Bunkut	Kastriot
Sibovc - Trungu i Blirit	Kastriot
Mazkit - Trungu i Manit	Kastriot
Grabovc - Burimi i Ujit Mineral	Kastriot
Grabovc - Kompleksi i Drurëve të Qarrit dhe Shkozës	Kastriot
Breznicë - Kompleksi i Burimeve	Kastriot
Cerrë - Trungjet e Manit	Istog
Lubozhdë - Trungu i Blirit	Istog
Vrellë - Burimi i Ujit	Istog
Istogu i Poshtëm - Trungu i Blirit	Istog
Shushic e Epërme - Trungu i Blirit	Istog
Istog - Burimi i Ujit	Istog
Zhakovë - Trungu i Bungut	Istog
Uqë - Trungu i Bungut	Istog
Cërkolez - Kompleksi i Trungjeve të Dushkut	Istog
Kaliqan - Trungu i Blirit	Istog
Baicë - Trungu i Blirit	Istog
Banjë - Burimi i Ujit Termomineral	Istog
Lubovë - Trungu i Blirit	Istog
Zallq - Trungu i Bungut	Istog
Zabllaq - Trungu i Bungut	Istog
Turbuhovc - Trungu i bungut	Istog
Saradran - Trungu i Bungut	Istog
Gjelbishtë - Uji Mineral	Vushtrri
